| | |
|---|---|
| Emërtimi dhe Forma ligjore | **ARKONSTUDIO** |
| NIPT-i | **L42019004I** |
| Adresa e Selisë | **Rruga Frosina Plaku, Pallati nr.21,** |
| Vendi | **Shkalla A, Apartamenti nr.5, Kati III - te,Tirane** |
| Data e krijimit | **19.08.2014** |
| Nr. i Regjistrit tregtar | **QKR** |
| Veprimtaria Kryesore | **Studio projektimi, supervizioni dhe kolaudimi:** |
| | **Masterplane - studime e plane racionale urbanistike** |
| | **plan rregullues te pergjithshem per qendra te banuara - qytete,** |
| | **studime pjesore urbanistike** |
| | **projektim objekte civile - industrial - turistike deri 5 kate** |

# PASQYRAT FINANCIARE

(Në zbatim të Standartit Kombetar të Kontabilitetit nr.2
dhe ligjit Nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare")

## VITI 2017

| | |
|---|---|
| Pasqyrat Financiare janë individuale | |
| Pasqyrat Financiare janë të shprehura | në vlerë reale leku |
| Periudha Kontabël e Pasqyrave Financiare | Nga 01.01.2017 deri 31.12.2017 |
| Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare | 25.03.2018 |

# Permbajtja

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR ..... 3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR ..... 6
PASQYRA E PERFORMANCES DHE TE ARDHURAT GJITHEPERFSHIRESE ..... 7
PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE ..... 8
PASQYRA E NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT NETO ..... 9
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE ..... 10
1. Te pergjithshme ..... 10
2. Bazat e pergatitjes ..... 10
3. Shenime shpjeguese ..... 11

# RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Për Ortakun e Vetem dhe Administratorin e shoqërisë ARKONSTUDIO SHPK

## Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë ARKONSTUDIO SHPK (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë në datën 31 Dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit te përmirësuara, ne Shqiperi (SKK).

## Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqiperi, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

## Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale perveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e proçesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

**Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë proçedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.

- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për proçesin e auditimit me qëllim hartimin e proçedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.

- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, perveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

28 Maj 2018

Sokol Toska
Auditues Ligjor

Auditues Ligjor
SOKOL TOSKA
L62207031A
Tirana - Albania

Rr. Tish Dahia,
Kompleksi Kika 2,Kulla 2, Nr. 33
Tirana 1060, Albania
+355 683317751
contact@toska.al
L62207031A

**ARKONSTUDIO SHPK**
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017**
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

# PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Me 31 Dhjetor 2017

| **AKTIVET** | Shenime | **Viti 2017** | **Viti 2016** |
|---|---|---|---|
| **Aktivet afatshkurtra** | | | |
| Mjete monetare | 3.a | 239,086 | 27,634,894 |
| | | 239,086 | 27,634,894 |
| Aktive te tjera financiare afatshkurtra | | | |
| Llogari / Kerkesa te arketueshme | 3.b | 105,233,009 | 6,598,868 |
| Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme | 3.b | 473,167 | 0 |
| | | 105,706,176 | 6,598,868 |
| **Aktivet totale afatshkurtra** | | 105,945,262 | 34,233,762 |
| **Aktivet afatgjata** | | | |
| Investimet financiare afatgjata | | | |
| Aktive afatgjata materiale | 3.c | 1,965,989 | 1,555,117 |
| **Totali i aktiveve afatgjata** | | 1,965,989 | 1,555,117 |
| **TOTALI I AKTIVEVE** | | **107,911,251** | **35,788,879** |
| **PASIVET DHE KAPITALI** | | | |
| **Pasivet Afatshkurter** | | | |
| Huamarjet | 3.d | 24,700,000 | 0 |
| Te pagueshme ndaj furnitoreve | 3.d | 34,527,831 | 2,532,133 |
| Te pagueshme ndaj punonjesve | 3.d | 864,330 | 1,011,528 |
| Detyrime tatimore | 3.d | 3,456,667 | 5,337,026 |
| **Totali i pasiveve Afatshkurter** | | 63,548,828 | 8,880,687 |
| **Pasivet Afatgjata** | | | |
| **Totali i pasiveve Afatgjata** | | 0 | 0 |
| **Totali detyrimeve** | | 63,548,828 | 8,880,687 |
| **KAPITALI** | | | |
| Kapitali | | 100,000 | 100,000 |
| Fitime te pa shperndara | | 26,808,192 | 339,695 |
| Fitim ( Humbj) e vitit financiar | | 17,454,232 | 26,468,497 |
| **Totali i kapitalit** | | 44,362,423 | 26,908,192 |
| **TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT** | | **107,911,251** | **35,788,879** |

**KONTABILIST** **ADMINISTRATORI**

ARKONSTUDIO PROJEKTIM/NDERTIM L42019004I

*Pasqyrat financiare lexohen se bashku me shenimet shpjeguese.*

# PASQYRA E PERFORMANCES DHE TE ARDHURAT GJITHEPERFSHIRESE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

| | Shenime | Viti 2017 | Viti 2016 |
|---|---|---|---|
| Shitjet neto | 3.e | 301,001,005 | 197,083,125 |
| Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit | | 0 | 0 |
| Ndryshimet ne inventarin e produkteve te gatshme dhe punes ne proces | | 0 | 0 |
| Puna e kryer nga njesia ekonomike raportuese per qellimet e veta dhe e kapitalizuar | | 0 | 0 |
| Mallrat, lendet e para dhe sherbimet | 3.f | -265,104,154 | -151,913,739 |
| Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit | 3.g | -1,272,042 | -1,843,296 |
| Shpenzime te personelit | 3.h | -13,027,120 | -11,992,883 |
| Renia ne vlere (zhvleresimi) dhe amortizimi | 3.c | -507,961 | -152,491 |
| **Fitimi (humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit** | | **21,089,728** | **31,180,716** |
| Te ardhura te tjera | | 0 | 0 |
| Shpenzimet financiare | 3.i | -505,687 | -10,010 |
| **Fitimi (humbja) para tatimit** | | **20,584,041** | **31,170,706** |
| Shpenzimet e tatimit mbi fitimin | 3.j | -3,129,809 | -4,702,209 |
| **Fitimi (humbja) neto e vitit financiar** | | **17,454,232** | **26,468,497** |
| **Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:** | | | |
| Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja | | 0 | 0 |
| Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale | | 0 | 0 |
| Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktivet financiare të mbajtura për shitje | | 0 | 0 |
| Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet | | 0 | 0 |
| **Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin** | | **0** | **0** |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin** | | **17,454,232** | **26,468,497** |
| **Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:** | | | |
| *Pronarët e njësisë ekonomike mëmë* | | *26,468,497* | *449,543* |
| *Interesat jo-kontrolluese* | | *0* | *0* |

KONTABILIST

ADMINISTRATORI

ARKONSTUDIO PROJEKTIM/NDËRTIM L42019004I

*Pasqyrat financiare lexohen se bashku me shenimet shpjeguese.*

**ARKONSTUDIO SHPK**
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017**
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

# PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

| | Viti 2017 | Viti 2016 |
|---|---|---|
| **Fluksi i parave nga veprimtarite e shfrvtezimit** | | |
| Fitimi para tatimit | 20,584,041 | 31,170,706 |
| Rregullime per: | | |
| Amortizimin | 507,961 . | 152,491 |
| Humbje nga kembimet valutore | 0 | 0 |
| Te ardhura nga investimet | | |
| Shpenzime per interesa | | |
| Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesave te arketueshme te tjera | -99,107,309 | 2,670,818 |
| Rritie/renie ne tepricen inventarit | 0 | 3,077,645 |
| Rritie/renie ne tepricen e detyrimeve, per t'u paguar nga aktiviteti | 51,538,332 | -11,145,279 |
| *Parate e perftuara nga aktivitetet* | -26,476,975 | 25,926,381 |
| Interesi i paguar | | |
| Tatimfitimi i paguar | | |
| | -26,476,975 | 25,926,381 |
| **Fluksi i parave nga veprimtarite investuese** | | |
| Bleria e shoqerise se kontrolluar X minus parate e arketuara | | |
| Blerja e aktiveve afatgiata materiale | -918,833 | -1,408,409 |
| Te ardhura nga shitja e paiisjeve | | |
| Interesi i arketuar | | |
| Dividendet e arketuar | | |
| Paraja neto, e perdorur ne aktivitetet investuese | -918,833 | -1,408,409 |
| **Fluksi i parave nga veprimtarite financiare** | | |
| Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar | | |
| Te ardhura nga huamarrie afatgjata | 0 | 0 |
| Pagesat e detyrimeve te qirase financiare | | |
| Dividendet e paguar | 0 | 0 |
| Para neto e verdorur ne aktivitetet financiare | 0 | 0 |
| **Rritja/renia neto e mjeteve monetare** | -27,395,808 | 24,517,972 |
| **Mjetet monetare ne tillim te periudhes kontabel** | **27,634,894** | **3,116,922** |
| **Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel** | **239,086** | **27,634,894** |

**KONTABILIST** **ADMINISTRATORI**

ARKONSTUDIO PROJEKTIM/NDERTIM L42019004I

*Pasqyrat financiare lexohen se bashku me shenimet shpjeguese.*

# PASQYRA E NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT NETO

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

| | Kapitali aksionar që i përket aksionarëve të shoqërisë mëmë | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Kapitali aksionar** | **Fitimi I Pashpërndarë** | **Fitim (Humbje) e vitit financiar** | **Totali** | **Zotërimet e aksionarëve të pakicës** | **Totali** |
| **Pozicioni më 31 Dhjetor 2015** | **100,000** | **-109,848** | **449,543** | **439,695** | | **439,695** |
| Efekti i ndryshimeve në politikat | | | | 0 | | 0 |
| Pozicioni i rregulluar | | | | 0 | | 0 |
| Efektet e ndryshimit të kurseve të këmbimit gjatë konsolidimit | | | | 0 | | 0 |
| Totali i të ardhuraveapo I shpenzimeve, që nuk janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve | | | | 0 | | 0 |
| Fitimi neto i vitit financiar | | | 26,468,497 | 26,468,497 | | 26,468,497 |
| Dividendët e paguar | | | | 0 | | 0 |
| Transferime në rezervën e detyrueshme statusore | | | | 0 | | 0 |
| Destinime te tjera | | 449,543 | -449,543 | 0 | | 0 |
| Emetim i kapitalit aksionar | | | | 0 | | 0 |
| **Pozicioni më 31 Dhjetor 2016** | **100,000** | **339,695** | **26,468,497** | **26,908,192** | **0** | **26,908,192** |
| Efekte të ndryshime të kurseve të këmbimit gjatë konsolidimit | | | | 0 | | 0 |
| Totali i të ardhurave apo shpenzimeve, që nuk janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve veprim rregu me humb mbartur | | | | 0 | | 0 |
| Fitimi neto për periudhën kontabël | | | 17,454,232 | 17,454,232 | | 17,454,232 |
| Dividendët e paguar | | | | 0 | | 0 |
| Transferime në rezervën e detyrueshme statusore | | | | 0 | | 0 |
| Destinime te tjera | | 26,468,497 | -26,468,497 | 0 | | 0 |
| Emetim i kapitalit aksionar | | | | 0 | | 0 |
| Aksione të thesarit të riblera | | | | 0 | | 0 |
| **Pozicioni më 31 Dhjetor 2017** | **100,000** | **26,808,192** | **17,454,232** | **44,362,423** | **0** | **44,362,423** |

**KONTABILIST** **ADMINISTRATORI**

*Pasqyrat financiare lexohen se bashku me shenimet shpjeguese.*

# SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

## 1. Te pergjithshme

Shoqeria "ArkonStudio" shpk eshte themeluar shoqeri dhe pergjegjesi te kufizuar ne date 19 Gusht 2014.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit 7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare" si dhe nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Objekti i shoqerise eshte "Studio projektimi, supervizioni dhe kolaudimi: Masterplane - studime e plane racionale urbanistike, plan rregullues te pergjithshem per qendra te banuara - qytete, studime pjesore urbanistike, projektim objekte civile - industrial - turistike deri 5 kate".

Shoqeria kryen aktivitetin e saj ne ambjent te marre me qira

Numri i punonjesve me date 31 Dhjetor 2017 ka qene 73 (shtatedhjeteetre)

## 2. Bazat e pergatitjes

Deklarimet financiare te bashkangjitura jane pergatitur ne baze te rregjistrimeve kontabel te mbajtura per qellime te kontabilitetit te vendit konform Ligjit 9228 date 29 Prill 2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Pasqyrat Financiare te fund vitit jane paraqitur ne formatin e paraqitur ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne fuqi (SKK 2).

Sipas parimeve te kontabilitetit ne Shqiperi deklarimet financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit te te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Pergatitja e pasqyrave Financiare ne perputhje me kerkesat e SKK, kerkon perdorimin e disa vleresimeve kontabile te rendesishme. Kjo gjithashtu kerkon qe manaxhimi i Shoqerise te jape gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabile te saj. Fushat te cilat kerkojne nje shkalle te larte ose komplekse te gjykimit ose ato per te cilat vleresimet apo supozimet jane te rendesishme per hartimin e pasqyrave financiare paraqiten ne shenime.

Shpenzimet qe lidhen me te ardhurat e fituara gjate periudhes raportuese njihen ne te njejten periudhe kontabel si dhe te ardhurat perkatese.

Shpenzimet e kryera gjate nje periudhe raportuese, qe ndryshon nga periudha kur ato i sjellin perfitime njesise ekononike raportuese, rregjistrohen si shpenzime pikerisht ne periudhen kur merren perfitimet.

Mbajtja e kontabilitetit, i cili perfshin si regjistrimet kontabel dhe sistemin e tij, mbahen ne menyre te kompjuterizuar, me ane te nje programi te kontabilitetit.

Deklarimet financiare jane shprehur ne Leke, e cila eshte monedha shqiptare.

# SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE (vazhdim)

## 3. Shenime shpjeguese

3.a Mjete monetare perfaqeson Depozita ne banke ne vlere 239,086.00 leke . Per llogarite ne valute eshte bere azhornimi me kursin e dates 31.12.2017

| | 31 Dhjetor 2017 | 31 Dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| | | |
| Llogari rrjedhese ne banke | 239,086 | 27,634,894 |
| **Totali** | **239,086** | **27,634,894** |

3.b Kerkesa te arketueshme jane ne vleren prej 105,706,177 leke si me poshte:

- Kliente ne shumen 105,233,010 Leke
- Shteti tatim fitimi i mbipaguar 473,167 Leke

| | 31 Dhjetor 2017 | 31 Dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| | | |
| Kliente per shitje | 105,233,009 | 6,598,868 |
| Kerkesa te tjera te arketueshme | 473,167 | 0 |
| **Totali** | **105,706,176** | **6,598,868** |

3.c Aktive afatgjate materiale Shoqeria ka nje vlere neto aktivesh afatgjate materiale prej 1,965,989.00 leke. (Vlere Historike 2,644,658 leke -Amortizim -678,669 leke)

**Aktivet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2017**

| Nr | Emertimi | Sasia | Gjendje 1/1/2017 | Shtesa | Pakesime | Gjendje 12/31/2017 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mjete transporti | | 1,098,640 | 0 | 0 | 1,098,640 |
| 2 | kompjuterike,zyre,etj | | 627,185 | 918,833 | 0 | 1,546,018 |
| | *TOTALI* | | *1,725,825* | *918,833* | *0* | *2,644,658* |

**Amortizimi A.A.Materiale 2017**

| Nr | Emertimi | Sasia | Gjendje 1/1/2017 | Shtesa | Pakesime | Gjendje 12/31/2017 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mjete transporti | | 36,621 | 212,404 | | 249,025 |
| 2 | kompjuterike,zyre,etj | | 134,087 | 295,557 | | 429,644 |
| | *TOTALI* | | *170,708* | *507,961* | *0* | *678,669* |

**Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2017**

| Nr | Emertimi | Sasia | Gjendje 1/1/2017 | Shtesa | Pakesime | Gjendje 12/31/2017 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mjete transporti | | 1,062,019 | (212,404) | - | 849,615 |
| 2 | kompjuterike,zyre,etj | | 493,098 | 623,276 | - | 1,116,374 |
| | *TOTALI* | | *1,555,117* | *410,872* | *0* | *1,965,989* |

# SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE (vazhdim)

## 3. Shenime shpjeguese (vazhdim)

3.d Detyrimet afatshkurtra

Llogarite e detyrimeve paraqiten ne pasiv te deklarimeve financiare. Ne pasiv te bilancit gjendja e detyrimeve te shoqerise paraqitet si me poshte:

| | *31 Dhjetor 2017* | *31 Dhjetor 2016* |
|---|---|---|
| Furnitoret | 34,527,831 | 2,532,133 |
| Hua bankare(over-draft procredit bank) | 24,700,000 | 0 |
| Punonjes | 864,330 | 1,011,528 |
| Detyrime tatimore | 3,456,667 | 5,337,026 |
| **Totali** | **63,548,828** | **8,880,687** |

Detyrimet ndaj furnitoreve kapin shumen 34,527,831 leke .

Detyrimet tatimore dhe sociale:

Llogarite e sigurimeve shoqerore 476219 leke paraqiten ne bilanc me shumen per tu paguar ne fund te vitit 2017. Gjate vitit 2017 jane llogaritur dhe shlyer detyrimet per sigurimet shoqerore dhe ato shendetesore te cilat jane kalkuluar, rregjistruar dhe paguar pa pasaktesi.

Ne llogaritjen e detyrimeve shoqeria ka mbajtur parasysh kerkesat e Ligjit "Per TVSH", Ligjit "Tatimi mbi te ardhurat" duke i pasqyruar TVSH, tatimin mbi te ardhurat personale, te rregjistruar drejt dhe te papaguar me 31 Dhjetor 2017. FDP me 31.12.2017 kuadron me tepricen e llogarise . Detyrimet per tvsh 2975722 leke, detyrimet per tatim qirane kapin shumen 4726 leke, personeli 864330 leke tabela treguese me poshte:

| | *31 Dhjetor 2017* | *31 Dhjetor 2016* |
|---|---|---|
| TVSH | 2,975,722 | 826,958 |
| Sigurime shoqerore | 476,219 | 239,044 |
| Tatim Qiraje | 4,726 | 4,271,024 |
| **Totali** | **3,456,667** | **5,337,026** |

3.e Paraqiten te ardhurat e realizuara gjate periudhes.

| | *31 Dhjetor 2017* | *31 Dhjetor 2016* |
|---|---|---|
| Shitje Sherbimeve ndertimore | 301,001,005 | 197,083,125 |
| **Totali** | **301,001,005** | **197,083,125** |

# SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE (vazhdim)

## 3. Shenime shpjeguese (vazhdim)

3.f Paraqiten kostot e materialeve dhe sherbimeve te ndertimit.

| | *31 Dhjetor 2017* | *31 Dhjetor 2016* |
|---|---|---|
| Blerje materiale dhe te tjera | 214,502,823 | 143,838,581 |
| Ndryshimi gjendjes | 0 | 3,077,645 |
| Punime te nenkontraktuara | 50,601,331 | 4,997,513 |
| **Totali** | **265,104,154** | **151,913,739** |

3.g Paraqiten shpenzimet e tjera te shfrytezimit

| | *31 Dhjetor 2017* | *31 Dhjetor 2016* |
|---|---|---|
| Bl Energji Uje,avull | 80,630 | 128,130 |
| Qira | 210,000 | 252,000 |
| Mirembajtje, | 168,873 | 10,000 |
| Pagese per sherbime,sigurime | 363,612 | 474,561 |
| Shpenzime udhetim dieta | 0 | 109,969 |
| Shpenzime Telefonike | 31,706 | 20,067 |
| Shpenzime Transport ne blerje | 0 | 469,872 |
| Komisione Bankare | 68,568 | 68,945 |
| Taksa dhe tarifa vendore etj, | 67,300 | 132,395 |
| Penalitete,gjoba,demshperblime | 281,353 | 177,357 |
| **Totali** | **1,272,042** | **1,843,296** |

3.h Paraqiten shpenzimet e personelit

| | *31 Dhjetor 2017* | *31 Dhjetor 2016* |
|---|---|---|
| Paga | 11,168,650 | 10,303,800 |
| Sigurime shoqerore | 1,858,470 | 1,689,083 |
| **Totali** | **13,027,120** | **11,992,883** |

3.i Paraqiten shpenzimet financiare

| | *31 Dhjetor 2017* | *31 Dhjetor 2016* |
|---|---|---|
| Fitim nga kembime valutore | 0 | 10,010 |
| Shpenzime interesa over-draft | 505,687 | 0 |
| **Totali** | **505,687** | **10,010** |

# SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE (vazhdim)

## 3. Shenime shpjeguese (vazhdim)

3.j Paraqiten detaje te llogaritjes se tatimit mbi firmin.

| | *31 Dhjetor 2017* | *31 Dhjetor 2016* |
|---|---|---|
| Te Ardhurat | 301,001,005 | 197,083,125 |
| Shpenzime | 280,416,964 | 165,912,419 |
| Fitim Bruto | 20,584,041 | 31,170,706 |
| Shpenzime te pa njohura | 281,353 | 177,357 |
| Baza llogaritjes Tatimit | 20,865,394 | 31,348,063 |
| % e tatim Fitimit | 15 | 15 |
| **Tatim Fitimi** | **3,129,809** | **4,702,209** |
| **Fitimi NETO** | **17,454,232** | **26,468,497** |

**KONTABILIST**

**ADMINISTRATORI**

ARKONSTUDIO
PROJEKTIM/NDËRTIM
L42019004I